



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 25 shkurt 2022, në mbledhjen e II-të (dytë), mandati VII, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 13:25.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Fatlum Osmani U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Bahrije Mehmeti U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, Fatmir Rudari U.D. drejtor i drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, Avni Fetahu U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Bahri Selimi U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, për këtë mbledhje kemi parë një rend dite me 14 pika, është rend dite i cili ka shumë pika mirëpo besoj se janë pika që kalohen, para se ta hedh në votim rendin e ditës në qoftë se dikush ka për të shtuar diçka apo për të propozuar ndonjë pikë rreth rendit të ditës urdhëroni merreni fjalën.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, lidhur me rendin e ditës desha të propozoj një pikë për mbledhjen e radhës të asamblesë komunale, mirëpo kjo pikë nuk ka ardhë me materialin e rregullt të kësaj mbledhje dhe normalisht duke u bazuar në procedurë që kemi të drejtë të propozojmë që kjo pikë të kalojë përmes KPF-së. Bëhet fjalë për një subvencion prej 20,000.00€ për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave KRM “Pastrimi” Sh.a. dhe sa për informim këtu kemi një Marrëveshje të nënshkruar në vitin 2020, nga ish Kryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari dhe Kompanisë së “Pastrimit” sipas të cilës Komuna është zotuar se do t’i siguroj 100,000.00€ mbështetje për këtë kompani, që ka të bëjë me investime kapitale për ndërtimin e objektit. T’ju them të drejtën kjo mbështetje duhet të sigurohet përmes kategorisë së subvencioneve sepse bëhet fjalë për një etnitet të ndarë nga Komuna dhe e kemi të pamundur tani t’i sigurojmë 100,000.00€, mirëpo në bazë të mundësive tona buxhetore 20.000.00€, mund të ndahen si subvencion prandaj ne kërkojmë nga asambleja komunale që ky subvencion t’i ndahet Kompanisë “Pastrimi”.

Kjo pikë nuk ka hi si pikë e rregullt e rendit të ditës, besoj se do të kalojë përmes KPF-së dhe do t’i rekomandohet Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nga drejtori i DBF-së kërkoj një sqarim lidhur me këtë çështje, përkatësisht se a përfundon subvencionimi me këto 20,000.00€ apo do të duhet që të ndajmë edhe mjete tjera.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, Kuvendit nuk i mohohet e drejta që kur t'i ofrohen mundësitë buxhetore të ndihmij sërish me mjete financiare Kompaninë në fjalë, mirëpo tani nuk mund të ndajmë më shumë se 20,000.00€, sepse jemi të limituar nga kategoria e subvencioneve ku do të duhet të bëhet ky financim. Zotimi i Komunës për mbështetje financiare ka qenë 100,000.00€, mirëpo për vitet 2020-2021, nuk kemi mund ta ndihmojmë Kompaninë “Pastrimi” sepse kemi qenë me 760,000.00€, subvencione në vitin 2021, duke i përfshirë gjitha shërbimet, mallra, shëndetësi, arsim, kurse këtë vit në kategorinë e subvencioneve kemi të ndara 960,000.00€, kështu që na është krijuar një hapësirë e vogël për ndarjen e 20,000.00€. Në rast se në rishikime buxhetore thuhet diçka tjetër pastaj krijohen mundësi tjera dhe mbetet vendim i radhës i asamblesë komunale se a do të ndajë subvencion për Ndërmarrjen Publike - Kompania “Pastrimi”. Informatat janë që përveç këtij zotimi të Komunës është edhe gjendja e rëndë financiare e Kompanisë në fjalë, mirëpo ky është zotim i Komunës në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit dhe si do që të jetë e konsiderojmë të arsyeshëm këtë subvencion andaj edhe kërkoj që ky propozim t'i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit të Komunës i cili pastaj të vendos ashtu siç e mendon se a ta miratoj apo jo.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa e kuptova unë këtu kemi të bëjmë me një zotim dhe ne tani jemi në një situatë se a do ta përmbushim një zotim që është bërë para dy viteve, dhe nga ajo që po shohë është një formë që po mundoheni ta përmbushni një zotim që është bërë nga dikush tjetër. Natyrisht nëse ju e shihni të arsyeshme edhe pse ne nuk po mundemi ta përmbushim plotësisht zotimin.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare; Ndërmarrjes Publike – Kompania Regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” Sh.a. sipas materialeve të sjella nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e hedh në votim që të përfshihet në kuadër të rendit të propozuar të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoj se njëzëri u përkrahë kërkesa e drejtorit të DBF për përfshirje në kuadër të rendit të propozuar të ditës si pikë shtesë edhe pika shtesë;

- *Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” Sh.A. (dhe atë sipas renditjes në rendit të ditës).*

z.Bashkim Sylja, theksoi, kam një propozim për marrjen e një vendimi për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020. Propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.

Pra kërkesa është që ky propozim të futet si pikë shtesë e rendit të ditës, ndërsa arsyet besoj të gjithë i dimë që kanë të bëjnë me orarin e punës për ditën e diele për çka ka shumë kërkesa nga të gjitha bizneset, andaj si propozim të përfshihet në kuadër të rendit të ditës, të trajtohet dhe t'i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit të Komunës për mbledhjen e radhës të caktuar tash më.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa kuptova unë, parafolësi propozoi që të futet si pikë e re e rendit të ditës pezullimi i rregullores që ka përcaktuar orarin e punës për biznese, a është kështu.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë bëra një propozim vendim për pezullimin e disa neneve të rregullores që është në fuqi e që ndalon punën e bizneseve gjatë ditës së diele. Kjo pikë e rendit të ditës ka qenë edhe në mandatin e kaluar si propozim i Kryetarit, andaj unë bëra propozimin për pezullim të disa neneve të kësaj rregulloreje deri sa të nxirret rregullorja e re e cila e rregullon këtë çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, me vetë faktin në atë moment që ne e debatojmë rregulloren dhe heqim apo shtojmë diçka në atë rregullore atëherë është pikë e rendit të ditës për diskutimin e rregullores në fjalë. Kjo rregullore që përcakton orarin e bizneseve ka më shumë se një vit që ka ardhë në Kuvend dhe është

bërë shumë zhurmë dhe njëfarë forme shumë biznese e kanë parë më shumë si ç' rregullim se sa një rregullore që rregullon, dhe nga kjo që u tha unë propozoj që në një mbledhje të radhës ta diskutojmë rregulloren si tërësi dhe të marrim një vendim qoftë për pezullimin e saj të tërësishëm sepse kur është hartuar kjo rregullore ka pas për qëllim gjoja se do t'i mbrojë të drejtat e punëtorëve për ta pasë ditën e diele si ditë pushimi. Unë konsideroj se këtu janë ngatërruar pak kompetencat sepse dita e diele dhe ditët e pushimit nuk rregullohen me rregullore por me Ligjin e punës, dhe se a kanë punëtorët ditë pushimi apo jo, për këtë çështje është Inspektorati i punës, por jo rregullorja.

Prandaj propozoj që në një mbledhje të ardhme të sjellët një propozim i tillë si pikë e veçantë e rendit të ditës dhe të diskutohet e rregullorja në tërësi ngase në qoftë se diskutohet vetëm pjesërisht kjo rregullore atëherë nuk e di se a e kemi kryer punën apo vetëm po vazhdojmë tutje.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, dua të kyçem në këtë temë sepse kam qenë anëtar i Kuvendit kur është miratuar kjo rregullore për herë të parë dhe në një aspekt e kemi bllokuar veten me këtë rregullore prandaj mendoj se e vetmja mundësi është që kjo rregullore të pezullohet pastaj Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të filloj hartimin e një rregulloreje të re, këtë e kemi pasur praktikë më herët, ndoshta kishte me qenë më mirë që Kuvendi ta shfuqizoj këtë rregullore për një periudhë kohore deri sa të vije si pikë e rendit të ditës në Kuvend rregulloreje e re.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të filloj draftimin e një rregulloreje të re sepse ajo e përcakton orarin e punës për të gjitha bizneset. Shfuqizimi i tërësishëm i kësaj rregulloreje paraqet problem por të draftohet rregullorja e re për orarin e punës për ditën e diel dhe të bëhet plotësim ndryshim i rregullores bazë. Ne më parë në Kuvend e kemi pezulluar këtë rregullore në kohën sa ishin në vendlindje bashkatdhetarët tanë nga mërgata deri më 30 shtator, mirëpo pastaj sërish e njëjta rregullore është kthyer në implementim. Si Kuvend nëse e shihni të arsyeshme këtë rregullore mund ta shfuqizoni derisa të përgatitet draft rregullorja e re, mirëpo kjo procedurë është goxha e ndërlikuar e për këtë kemi pasur disa probleme për çka sigurisht është në dijeni edhe z.Qëndrim Softolli sepse ka qenë pjesë e legjislaturës së kaluar të Kuvendit kur kemi tentuar që ta shfuqizojmë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, anëtarët e këtij Kuvendi që kanë qenë pjesë e legjislaturës së kaluar kur është miratuar kjo rregullore kanë njohuri më shumë se ne rreth draftimit të saj, por nuk e di se a mund të kaloj ky propozim si plotësim i asaj rregulloreje.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, Kuvendi i Komunës mund ta pezulloj këtë rregullore deri në një afat të caktuar kohor pastaj Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik mund të dal me propozime të reja.

z.Bashkim Sylja, propozimi im ishte që të bëhet pezullimi i disa dispozitave të asaj rregulloreje, kurse sa i përket ndryshimit të tërësishëm të rregullores pastaj është çështje tjetër sepse duhet të dal në dëgjim publik dhe procedura tjera e që për draftimin e saj merret Drejtoria përkatëse. Sa i përket dispozitave që unë i ceka dhe asaj që u cek nga parafolësi z.Fatmir Rudari, kjo rregullore ka ardhë dy - tri herë në Kuvend mirëpo nuk është hartuar asnjëherë në mënyrë të drejtë dhe nuk ka kaluar, për këtë arsye unë propozova që deri në miratimin e rregullores së re këto dispozita të pezullohen dhe bizneset të vazhdojnë punën edhe të dielave e që është edhe kërkesë e qytetarëve, përndryshe le të vendos Kuvendi se a të kaloj ose jo ky propozim.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne kemi një propozim të z.Bashkim Sylja të cilin nuk po e kundërshtojmë por është ndryshe nga propozimi i z.Fatmir Rudari, dhe tani jemi në një situatë që kemi një propozim për pezullimin e kësaj rregulloreje deri në miratimin e një rregulloreje të re dhe një propozim për pezullimin e disa dispozitave të caktuara të kësaj rregulloreje.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i DBPZHR, theksoi, Kuvendi nuk ka mundësi që t'i ndryshoj vetëm disa nene sepse kemi tentuar një herë dhe kjo nënkupton selektivitet por Kuvendi ka të drejtë që ta pezulloj

këtë rregullore dhe thjeshtë dita e diele të jetë ditë pune sepse atë pjesë të pushimeve e rregullon ligji ashtu siç e ceku z.Naim Çunaku, kështu që deri sa të miratohet rregullorja e re drejtori i DPZHE e fillon punën me grupet e interesit dhe e sjellë prapë në Kuvend draft rregulloren e re për miratim.

z.Bashkim Syla, theksoi, të sqarohemi sepse rregulloren në tërësi ne nuk mund ta anulojmë, ky propozim vendim ka ardhë duke u mbështetur edhe në vendimin e kaluar përkatës sipas të cilit ato dispozita për orarin e punës për ditën e diel janë pezulluar dhe u është lejuar puna bizneseve edhe gjatë ditës së diel që do të thotë se ky propozim vendim ka ardhë duke marrë për bazë ato dispozita, andaj ne këtu nuk mund të nxjerrim rregullore të re dhe sa e di unë Kuvendi nuk mund ta pezullojë rregulloren.

z.Qendrim Softolli, theksoi, ne i kemi propozuar Drejtorisë përkatëse plotësim ndryshimin e atij propozimi që sihte sjellë në atë kohë, mirëpo ai propozim ndryshim nuk ka qenë i qëlluar dhe nuk ka kaluar dy herë në Kuvend. Sa kam njohuri unë ne mund ta pezullojmë rregulloren në fjalë për një afat të caktuar kohor por duhet të bëhet draftimi i rregullores së re sepse pezullimi pa kohë të caktuar nuk mund të bëhet sepse është rregullore e komplikuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, propozoj që rregulloren që përcakton orarin e punës për biznese ta kemi si pikë të veçantë në një mbledhje tjetër të radhës në Kuvend dhe të kërkojmë nga DPZHE që ta paraqet kërkesën ashtu siç mendojnë qoftë me plotësim ndryshim apo me draftim dhe miratim të rregullores së re.

znj.Adelina Stubulla, theksoi, më mirë është që të shkojmë njëherë me procedurën e pezullimit të kësaj rregulloreje në mënyrë që të punojnë bizneset edhe të dielave se sa pastaj deri sa të kalojmë në procedurat e hartimit dhe draftimit të rregullore së re do të kalojnë dy ose tre muaj.

z.Qendrim Softolli, theksoi, nëse Inspektorati i punës do të kishte funksionuar ne nuk do të ishim detyruar që t'i mbyllim bizneset gjatë ditës së diel por ne e dimë se si funksionon Inspektorati i punës, andaj shumë punëtor dhe qytetarë e kanë mirëpritur këtë rregullore dhe për këtë jam dëshmitar sepse kam pasur kontakte të shumta me punëtorët, bizneset dhe qytetarët, por në anën tjetër ne e dimë se kjo rregullore ka mangësi të shumta.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, e hedh në votim propozimin e z.Bashkim Syla që është propozim për marrjen e vendimit për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.

Pas votimit Kryesuesi konstatoj se me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR, përkrahet kërkesa e z.Bashkim Syla për përfshirje në kuadër të rendit të ditës të hyjë edhe pika shtesë;

- **Propozim vendim për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re. (dhe atë sipas renditjes së rendit të ditës)**

z.Naim Çunaku, theksoi, mos të keqkuptohemi lidhur me këtë proces të votimit, por të theksohet se vota kundër nga radhët e Grupit të këshilltarëve të LDK-së është për arsye të formës se si u propozua për pezullim të dispozitave të cekura të Rregullores në fjalë, mirëpo si Grup kërkojmë që Rregullorja në fjalë të sjellët si pikë e veçantë për plotësim-ndryshim të tërësishëm në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit)

znj.Adelina Stublla, theksoi, kërkoj që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës edhe propozim Planit i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022, meqë kjo pikë e rendit të ditës ishte dashur të jetë më herët por në bazë të rrethanave që kanë qenë deri më tani nuk ka kaluar si pikë e rendit të ditës, andaj ne e propozojmë këtë pikë të rendit të ditës si pikë shtesë.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me propozimin edhe të një pike të rendit të ditës duke u nisur nga vetë fakti që i kemi 14 pika të propozuara të rendit të ditës dhe tani këtu u shtuan dy pika tjera dhe të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, atëherë po kalojmë në një rend dite të ngarkuar dhe jo pse është më pak i rëndësishëm plani i punës por me vetë faktin se plani i punës së Kuvendit është i rëndësishëm për punën e Kuvendit mendoj se ky propozim duhet të kalojë në një mbledhje të rregullt të radhës së Kuvendit dhe t'ju jepet më shumë kohë dhe hapësirë të gjithë anëtarëve të Kuvendit që të punojnë dhe ta kenë për bazë fushëveprimin në kontributin e tyre për atë se çfarë duan të kenë për një vit kalendarik të Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne e dimë se plani i punës është dashur të miratohet në muajin janar mirëpo arsyeja është se kemi pas zgjedhje të reja dhe qeverisje të re komunale. Kur dihet se plani i punës nuk mund të bëhet kur nuk janë të emëruar drejtorët e Drejtorive përkatëse sepse të gjithë drejtorët planet i punës i inkorporojnë në planin e punës së Kuvendit, kështu që ne jemi konsultuar, drejtorët kanë qenë prezent, plani i punës është hartuar dhe besoj se nuk do të ketë ndonjë pengesë që kjo pikë të futet si pikë shtesë e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues, unë nuk thash se plani i punës nuk është i përgatitur apo pse është vonuar sepse e di kur e kemi marrë mandatin, mirëpo duhet të ketë më shumë hapësirë për diskutim në mënyrë që secili të jap kontribut për një plan të punës më të efektshëm dhe kaq ishte kundërshtimi im. Ndërsa për arsyetimin e juaj që thoni për planin e punës them se së bashku me plan të punës është dashur të sjellët edhe raporti i punës së Kuvendit, mirëpo në këtë rast ti nuk mund të japësh raport të punës së Kuvendit kur s'ke qenë pjesë e tij.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani po kalojnë tre muaj pa miratimin e planit të punës dhe ne kemi edhe kritika në mjetet e informimit, kështu që unë propozoj që ky propozim të futet si pikë e rendit të ditës andaj propozimin në fjalë e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesues konstatoj se me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR, mbështetet kërkesa e znj.Adelinë Stublla për përfshirje në kuaëd të rendit të ditës si pikë shtesë.

- **Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022.** (dhe atë sipas renditjes së rendit të ditës, dhe njëkohësisht i'u shpërndahet propozim plani i punës së Kuvendit për vitin 2022)

Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrje dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe pikat shtesë sipas propozimeve të prezantuara.

Pas votimit, Kryesues i Komitetit konstatoj se me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR u mbështet rendi i propozuar i ditës sipas thirrje dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe pikat shtesë sipas propozimeve të prezantuara dhe përkrahura, dhe atë;

- **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” Sh.A.**
- **Propozim vendim për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.**
- **Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022.**

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 13.01.2022.

Njëzëri, pa plotësim ndryshime apo vërejtje, u miratuan procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më 13.02.2022.

2. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.

znj.Bahrije Mehmeti, U.D. drejtore e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, ne kemi sjellë si pikë të rendit të ditës Listën e veçantë të pronave për dhënie në shfrytëzim ashtu siç e keni marrë në bazë të materialit. Lista e veçantë e pronave është e përcaktuar me Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme dhe me rregullore të veçantë. Për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Komunën tonë kjo listë nuk është proceduar, mirëpo Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal Kryetarëve të Komunave ju ka dërguar shkresë se Listat e veçanta mund të procedohen deri më datë 31 mars 2022. Materialin e keni marrë me kohë, besoj se e keni parë Listën në fjalë që është për publikim.

z.Qendrim Softolli, theksoi, sa i përket Listës së veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim nga ana e Komunës ne së pari kërkojmë nga Drejtoria përkatëse që të na e sjellë listën e përgjithshme të pronave të Komunës së Podujevës dhe gjendjen reale të tyre dhe nga kush janë duke u shfrytëzuar ato prona, përndryshe ne jemi kundër kësaj forme selektive, prandaj nuk e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës pa e pas listën totale të pronave dhe gjendjen e tyre.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Nga 8 anëtarë që ishin prezent në procesin e votimit, me 5 vota PËR dhe 3 vota KUNDËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.

3. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sipas materialit që kemi këtu ne duhet t’i propozojmë Kuvendit dy anëtar për emërim në Komisionin përkatës, kurse një anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës, Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështet si pikë pasi që është procedurë dhe rregull i ndërmarrjes publike.

Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush tjetër dëshiron të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a. me theks që emrat e anëtarëve të Komisionit, nga radhët e Kuvendit, të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe për këtë pikë kemi një situatë të njëjët sikurse për pikën paraprahe, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë. me theks që emrat e anëtarëve të Komisionit, nga radhët e Kuvendit, të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, po ashtu edhe kjo pikë është sikurse dy pikat paraprahe, prandaj urdhëroni mund ta merrni fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë., me theks që emrat e anëtarëve të Komisionit, nga radhët e Kuvendit, të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

6. Propozim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i i Komitetit, theksoi, sikurse Komitetin për Politikë dhe Financa ashtu edhe Komitetin për Komunitete duhet ta themelojë Kuvendi i Komunës dhe në bazë të thirrjes publike i kemi katër kërkesa apo 4 anëtar të komuniteteve që janë; Albina Avdiu nga Komuniteti Ashkali, Muhamet Sadiku nga Komuniteti Rom, Xhafer Ademi, nga Komuniteti Ashkali dhe Shkurte Sejdiu nga Komuniteti Ashkali, pra kemi 4 kërkesa që të cekurit të jenë pjesë e Komitetit për Komunitete, mirëpo kemi edhe një kërkesë të një serbi i cili ka konkuruar dhe i cili me letërnjoftim është banorë i Komunës mirëpo nuk është banorë rezident e që në Ligjin për vetëqeverisje lokale kërkohet që anëtari/ja e Komitetit për Komunitete të jetë banor rezident i Komunës. Ne për këtë rast ju kemi drejtuar Ministrisë përkatëse dhe nga ana e tyre është thënë që ta verifikojmë a banon dhe jeton në Komunën e juaj ai person, pra sipas informatave ai person nuk banon në Komunën tonë dhe ato letërnjoftime që i ka paraqitur janë persona të cilët kryesisht banojnë në Komuna tjera siç kemi rastin e njërit i cili banon në Zveqan, kështu që për këtë anëtar nga komunitetit serb nuk jam që të jetë anëtar i këtij Komitetit për Komunitete

z.Florent Hasani, theksoi, ne e dimë se ai person (i komunitetit Serb) më nuk jeton në fshatin Metergofc dhe thuhet se jeton në Komunën e Medvegjës, andaj jemi kundër përfshirjes së tij në Komitet.

z.Naim Çunaku, theksoi, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së Kuvendit është obligative ajo të cilën e ceku edhe Kryesuesi që ta konstituojmë Komitetin për Komunitete dhe rregullorja jonë përcakton që Komiteti për Komunitete të përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve, prej tyre 4 anëtarë janë prej Kuvendit kurse anëtarët tjerë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve jo shumicë. Duke marrë para sysh këtë, ne vetëm mund t'i propozojmë Kuvendit themelim në bazë të formulës së përbërjes së anëtarëve që duhet të jetë kjo përbërje, dhe atë 4 anëtarë nga radhët e Kuvendit dhe 5 anëtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë, ndërsa specifikisht për emra do të debatojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Sigurisht nëse nuk ka gatishmëri prej komuniteteve Rom, Ashkali apo Egjiptas dhe kemi mungesë të vullnetit nga ato komunitete që të jenë pjesë e komitetit, si dhe për komunitetin Serb që nuk e di saktë por e besoj atë që u potencua më herët që nuk janë banorë rezident të Komunës sonë, gjithçka që e rregullon ligji ne nuk kemi diçka tjetër vetëm se ta aprovojmë andaj propozoj që Kuvendit t'ia rekomandojmë themelimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete.

z.Bahri Selimi, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku, mesa di unë Komiteti për Komunitete nuk përbehet në mënyrë decitive prej 9 anëtarëve por në bazë të konkurrimit/propozimeve nga ana e komuniteteve jo shumicë sepse shumicën e përbërjes së Komitetit duhet ta kenë komunitetet jo shumicë.

Pra kemi rastin ku janë 4 anëtarë të cilët kanë aplikuar nga radhët e komuniteteve jo shumicë e që nënkupton vetvetiu se 3 anëtar duhet të jenë prej Kuvendit apo komunitetit shumicë dhe përbërja e këtij Komiteti në këtë rast duhet të jetë prej 7 anëtarëve sepse nuk e kemi edhe një anëtar të komuniteteve por janë vetëm 4 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës nuk ceket në mënyrë decitive se përbërje e këtij Komiteti duhet të jetë prej 9 anëtarëve, prandaj duhet ta keni para sysh këtë fakt sepse edhe afati i thirrjes publike ka përfunduar dhe në këtë rast duhet të jenë 3 anëtar nga radhët e Kuvendit.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, sipas rregullativës ligjore nëse përbëhet komiteti prej 9 anëtarëve prej tyre 5 anëtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve pakicë, në qoftë se janë 7 anëtarë atëherë 4 prej tyre duhet të jenë nga radhët e komuniteteve pakicë kurse 3 anëtar nga radhët e Kuvendit. Në rastin konkret ne kemi 4 anëtarë nga radhët e komuniteteve atëherë duhet të jenë edhe 3 anëtar nga radhët e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne e kemi një Udhëzim Administrativ dhe ligjin me të cilin saktësisht përcaktohet se si themelohen komitetet, mirëpo nuk është përcaktuar se sa duhet të jetë numri i

anëtarëve të komitetit 9 apo 7 anëtar, Edhe në diskutimin tim e thash që anëtarët e komuniteteve duhet të jenë shumicë në përbërjen e Komitetit për Komunitete, dhe në Kuvend mbetet që të vendoset që kjo përbërje e Komitetit për Komunitete të jetë 7 apo 9 anëtarë. Prandaj nga ajo që u prezantua sot kemi 5 kandidat që kanë aplikuar ku njëri prej tyre nuk i plotëson kushtet që të jetë anëtar i Komitetit, mbetet që të vendoset në mbledhjen e Kuvendi.

Kryesues i Komitetit. theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë këtë pikë të rendit të ditës e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe që emrat e anëtarëve të Komitetit për Komunitete të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, Propozimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete me theks që emrat e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, përveç atyre të Komuniteteve jo shumicë që janë sjellë, të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

7. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. - Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, deri më tani Komuna e Podujevës ka operuar me një rregullore të vitit 2012, e që ka ekzistuar një mendim i përgjithshëm se kjo rregullore ka shumë mangësi dhe disa fusha nuk i parasheh fare për subvencionim, gjithashtu ka mundësi që nuk parasheh edhe kriteret e sakta dhe strikte për ndarje të subvencioneve, andaj ka ardhë si detyrë e domosdoshme përpilimi i një rregulloreje të re. Normalisht kjo është një draft rregullore që do të vihet në diskutim publik pasi që të kaloj në Kuvend, afati për diskutim publik është një muaj dhe gjatë kësaj kohe presim vërejtjet dhe sugjerimet e të gjithëve në mënyrë që ta aprovojmë një rregullore që i përgjigjet më së miri detyrave të cilat përcaktohen me këtë draft rregullore.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështesim këtë propozim rregullore, sigurisht rregulloren e mëparshme koha e ka tejkaluar në disa sekuenca të caktuara dhe specifikisht kemi ardhur duke i rregulluar shumë më tepër kriteret që duhet t'i përmbajë një rregullore e re, prandaj edhe e mbështesim këtë propozim duke marrë parasysh faktin se kjo rregullore do të kaloj në diskutim publik dhe kontributi i të gjithë atyre që dëshirojnë ta pasqyrojnë apo t'i japin vërejtjet e tyre e kanë mundësinë që ta bëjnë një gjë të tillë.

Një pyetje kam për drejtorin e DBF-së sepse më bëri përshtypje një fjalë që ishte cekur në draft rregullore, ka të bëjë me subvencionimin e akcesorëve, andaj kjo fjalë do të ishte mirë të zëvendësohet.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, akcesorët janë te kategoria e subvencionimit të bizneseve dhe një prej arsyeve të domosdoshme për ndryshimin e rregullores ka qenë subvencionimi i bizneseve sepse rregullorja e kaluar nuk e ka përfshi këtë kategori. Tani ne i kemi paraparë edhe në ndarjen buxhetore 100,000.00€, në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ndërkohë që nuk e kemi pasur të rregulluar bazën ligjore kështu që nuk kemi mundësi të ecim tutje pa u ndryshuar kjo rregullore. Kategoritë e parapara për subvencionim në fushën e biznesit janë, të gjitha bizneset duke i përfshirë këto por duke mos u kufizuar në to, faktikisht në parim është për të gjitha bizneset, por mund ta ndërrojmë këtë ngase është në diskutim publik dhe normalisht mund të ndryshohet edhe në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, pyetja ime ishte, termi akcesorë, a mund të hiqet/zëvendësohet.

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, theksoi, ne në këtë draft rregullore i kemi cekur vetëm disa terme të bizneseve, mirëpo nuk kufizohemi vetëm në këto.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo e hedh në votim Propozim Rregulloren për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, përkatësisht Propozim vendimin për vënien në diskutim publik të kësaj draft rregulloreje duke rekomanduar që në mbledhjen e Kuvendit të caktohet kohëzgjatja e diskutimit publik dhe data e mbajtjes së debatit publik me qytetar.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, të propozim vendimit për vënie në diskutim publik të Propozim Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve në Komunën e Podujevës, me rekomandim që Kuvendi të caktohet kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe datën e mbajtjes së debatit publik me qytetar.

8. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Podujevës

- Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, në këtë propozim rregullore kemi punuar edhe në vitin e kaluar mirëpo meqenëse ishte vit zgjedhor nuk kemi dashur që të bënim politikë dhe ngarkesë në atë periudhë kohore, kemi pasur kohë të mjaftueshme që të punojmë andaj këtë propozim rregullore do ta hedhim në diskutim publik që së paku do të jetë një muaj dhe presim nga ana e juaj sugjerime, vërejtje, propozime në mënyrë që ta kemi një rregullore që do të jetë e përshtatshme për të gjitha shkollat. Nuk është se nuk kanë pasur rregullore shkollat e veçanta secila prej tyre, mirëpo kanë pasur një dis harmoni mes veti, andaj kjo rregullore i përcakton qartë detyrat, përgjegjësitë, që nga drejtori i shkollës deri te nxënësi duke i përfshirë të gjitha moshat të cilat ndërlidhen me të.

z.Naim Çunaku, theksoi, e mbështesim rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Podujevës dhe e përgëzoi për punën edhe pse mund të jem gabim por është hera e parë që rregullohet kjo çështje në mënyrë unike nga Komuna jonë, një rregullore e cila qartazi i përcakton kriteret e nxënësve dhe mësimit dhe të trupës ndihmëse - këshillit të prindërve.

Unë mendoj se kjo rregullore është e mirëseardhur dhe e mbështesim si të tillë që të del në diskutim publik.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, unë e njohë këtë fushë pasi që jam mësimit dhe besoj se është shumë e qëlluar e që mendoj se duhet të jetë një rregullore e hartuar mirë që t'ua lehtësoj punën menaxherëve të shkollave sepse ka probleme të ndryshme. Atëherë ngase u diskutua më lartë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, të propozim vendimit për vënie në diskutim publik të Propozim Rregullores për funksionimin e institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Podujevës, me rekomandim që Kuvendi të caktohet kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe datën e mbajtjes së debatit publik me qytetar.

9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, vetëm desha t'ju informoj se niveli qendror përkatësisht Ministria e Arsimit ka vendosur që në bazë të buxhetit aktual që ka të financoj ndërtimin e 7 çerdheve në nivel të Republikës së Kosovës ku në mesin e tyre është paraparë edhe ndërtimi i një çerdheje në Komunën e Podujevës. Kanë kërkuar prej DKA-së një vendim për ndarje të lokacionit dhe të procedohet komform procedurave nga ana e Ministrisë së Arsimit në mënyrë që të ndërtohet një çerdhe për të cilën, në bazë të projektit që na është dorëzuar ishte prej atyre moderne që janë. Ne i kemi zhvilluar procedurat me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe e kemi sjellë këtu para jush propozimin në fjalë.

z.Naim Çunaku, theksoi, sigurisht se do ta mbështesim këtë propozim, por duhet të jeni më të qartë sa i përket caktimit të lokacionit dhe se a kemi ne ndonjë propozim për këtë lokacion.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, besoj që përmes e-mailit ju ka ardhë materiali ku ceket edhe lokacioni i ndërtimit të çerdhes, ajo parcelë është pronë komunale dhe i atakon një numër të madh të banorëve që nuk kanë qasje të çerdhja aktuale sepse e dimë se kemi vetëm një çerdhe publike, andaj jemi munduar që ta mbulojmë këtë pjesë sipër spitalit e tutje. Besoj se lokacioni dhe skica ju është përcjellë përmes emailit.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit. theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës, sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, të jemi korrekt sa i përket ndërtimit të çerdhes në fshatin Batllavë është sepse ne në kuadër të buxhetit kemi planifikuar për çdo shkollë që ka rënie të numrit të nxënësve të lejojmë inkorporimin e parashkollorëve në objektet shkollore, mirëpo në Kuvendin e Republikës së Kosovës deputetët e Llapit kanë nxjerrë një amendament dhe në bazë të tij Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka ndarë 100,000.00€, mirëpo këto mjete kanë qenë të mirëseardhura dhe pikërisht ndërtimi i çerdhes do të bëhet të shkolla e vjetër e fshatit Batllavë.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit. theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje .

11. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, proceduralisht Drejtorja e Arsimit është e obliguar që çdo vit ta ngritë një komision të tillë. Ne e kemi pas një komision dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës parashihet që të jetë një zyrtar prej DKA-së, dhe një anëtar parashihet të jetë me prioritet Kryetari i Këshillit të Prindërve por mund të jenë edhe anëtar tjerë. Ne e kemi zbatuar Udhëzimin në fjalë dhe e kemi në përbërje Kryetarin e Këshillit të Prindërve dhe njëkohësisht caktohet edhe një anëtar prej Ministrisë së Arsimit.

Bëhet fjalë për 6 drejtor që ju skadon mandati dhe për fat kemi edhe disa të tjerë që janë ushtrues detyre deri në shpalljen e konkursit.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa i përket kësaj pike pa ndonjë lloj koment i nderuar drejtor, nëse në një formë siç na është paraqitur në Kuvend nuk jam duke e kundërshtuar Udhëzimin Administrativ, mirëpo pse të kaloj diçka në Kuvend kur Kuvendi nuk ka ndonjë propozim tjetër. Nëse është ashtu le të vazhdojmë por duhet ta dimë se a ka të drejtë Kuvendi për propozim të dikujt apo nuk ka kurrfarë të drejte në këtë aspekt.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, është shumë e sigurt që deri në vitin 2020, nuk ka qenë e nevojshme që propozimet të kalojnë në Kuvend, mirëpo tani Udhëzimi Administrativ parasheh miratimin e komisionit në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë nuk e kontestoj ishte pyetja te propozimet e emrave.

z.Avni Fetahu, U.D drejtor i DKA, theksoi, Udhëzimi Administrativ e parasheh një zyrtar të DKA-së, Kryetarin e Këshillit të Prindërve ose një profesionist të fushës që është i nivelit më të lartë, profesor universitar ose diçka të ngjashme, ne i kemi zbatuar këto procedura dhe i kemi propozuar ata dy emra që i takojnë DKA-së. Kryetarit i Këshillit të Prindërve është zgjedhur sipas procedurës së rregullt, andaj edhe presim miratim, nuk kemi mundësi të ndërhyrjes.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sigurisht kjo është bërë më shumë për ta informuar Kuvendin, mirëpo është edhe një procedurë për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Prindërve.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari z.Bashkim Sylja, unë pata kontest me Kuvendin sepse Kuvendi vetëm po miraton diçka të tillë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ishte vetëm një informim e sigurisht drejtori i DKA-së në seancën e Kuvendit do të vijë me material dhe do të na ofrojë informacione rreth gjendjes në arsim dhe në cilat shkolla ka mungesë të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, andaj në këtë kontekst ishte fjala ime që ka të bëjë me votimin e këtij komisioni.

z.Naim Çunaku, theksoi, krejt në rregull, por ne jemi këtu si vendimmarrës.

z.Hlimi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor të shkollave sipas materialit përkatës.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

12. Propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, e dini që në kuadër të Drejtorisë bënë pjesë edhe pylltaria, dhe për këtë çështje është një sasi e druve e cila është grumbulluar, dru këto që u janë marrë prerësve ilegal nga Policia dhe nga pylltarët e DBPZHR, kjo sasi ndodhet në deponi në fshatin Peran dhe ne si Drejtori kemi bërë 4 kërkesa për shitje përmes procedurës së prokurimit pasi që janë aset i Komunës, mirëpo nuk ka pasur të interesuar dhe na ka mbet e vetmja rrugë që përmes Kuvendit t'i ndajmë këto dru për familjet në nevojë.

Po ashtu është kërkesë edhe e ujës-jellësit që t'i lirohet hapësira pasi që këto dru gjenden në oborrin e ujës-jellësit. Në bazë të ekspertëve të pylltarisë ato dru janë duke e humbur efektin e tyre sepse ka më shumë se 3-4 vite që qëndrojnë në deponi rreth 350m³.

z.Naim Çunaku, theksoi, ky është një propozim i qëlluar dhe na gëzon për faktin se ne si Komunë po mund t'i ndihmojmë qytetarët tanë sepse kemi një gjendje jo të mirë socio- ekonomike, mirëpo dilema ime ishte se ato dru asnjëherë nuk janë konsideruar si aset i Komunës por si aset i Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe se mund të kemi pengesa ligjore, mirëpo këtë na e sqaroi drejtori parafolës dhe për fund më vjen mirë që këto dru janë në deponi dhe mund t'ju shpërndahen familjeve në nevojë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, ne së paku duhet ta kemi një sqarim se si shkon procedura e aplikimit përmes Ministrisë apo përmes Komunës.

z.Fatmir Rudari, U.D. drejtor DBPZHR, theksoi, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i posedon listat e familjeve që janë përfitues të asistencës sociale dhe nga kjo Drejtori formohet një komision që i zhvillon procedurat dhe thajse më shumë ata janë përgjegjës sepse i kanë të gjitha listat, ne jemi afër me zyre dhe për çdo ditë i shohim se kemi së paku nga 20 kërkesa të qytetarëve për t'ju siguruar dru për ngrohje. Në fillim ideja e Kryetarit ishte që kjo masë drusore të ndahet nëpër shkolla, mirëpo më vonë u konsultuam me drejtorin e DKA-së dhe ai na njoftoj se ekziston një kontratë për këtë vit dhe shkollat janë të furnizuara me lëndë drusore, andaj ne propozuam që kjo masë drusore t'iu ndahet familjeve në nevojë, gjithëherë në koordinim me DSHMS-në.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit. theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse atëherë e hedh në votim propozim vendimin për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike sipas materialit përkatës.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, sipas materialit përkatës të kësaj pike.

13. Propozim vendimi për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, dihet se është i formuar Asociacioni i 38 Komunave të Republikës së Kosovës ku pjesë e tyre është edhe Komuna e Podujevës dhe nga ana e tyre kemi kërkesë që edhe ne t'i dërgojmë përfaqësuesit e Komunës tonë në atë Asociacion, kështu që edhe ne do t'i rekomandojmë Kuvendit që t'i zgjedhë 4 anëtar nga radhët e Kuvendit duke përfshi edhe Kryetarin e Komunës i cili shkon me automatizëm, andaj këta 4 anëtar zgjedhën në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, forma e rregullimit të Asociacionit është e rregulluar sepse ata e kanë Kuvendin e tyre që përbëhet nga të gjithë këshilltarët e zgjedhur në nivel të Republikës së Kosovës dhe për 10 këshilltar është i rezervuar një vend kurse ne e kemi 35 këshilltar dhe i bie 3.5 por na është lejuar

që t'i kemi 4 anëtar. Poenta e kritikës është se në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës që përbëhet prej 38 Komunave kisha dashur që të jen pjesë e saj. Nuk e di se sa jeni duke më kuptuar sepse Komunitat me shumicë serbe nuk janë pjesë e saj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë e di se janë 38 Komuna të Republikës së Kosovës dhe ju po i kontestoni i nderuar Çunaku.

z.Naim Çunaku, theksoi, 38 Komuna janë të Republikës së Kosovës dhe nuk mund t'i kontestoj askush, mirëpo fjala ishte te pjesa përbërëse e Asociacionit të Komunave.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Asociacioni i Komunave të Republikës së Kosovës ju ka bërë ftesë gjitha Komunave që të bëhen pjesë e tij, kurse sa i përket asaj se a dëshirojnë të bëhen pjesë apo jo është çështje tjetër.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa për njoftim, Komuna e Mitrovicës së Veriut dhe Zubin Potokut nuk janë pjesë e Asociacionit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kjo është temë tjetër, ato Komuna janë të vetë përjashtuara dhe e kërkojnë të ashtuquajturën “zajdnice” mirëpo në takim ishte prezent edhe Kryetari i Komunës së Graçanicës, andaj nëse dëshironi fjalën rreth kësaj teme urdhëroni nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, me theks që përveç Kryetarit të Komunës, emrat e anëtarëve tjerë të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

14. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018.

znj.Bahrije Mehmeti, U.D. drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, ky propozim ka ardhë për arsye të mos kufizimit të dhënies në shfrytëzim të objektit vetëm për qëllime të hotelarisë dhe shëndetësisë por edhe për veprimtari tjera të ngjashme që t'ju ofrohet mundësia për marrje në shfrytëzim, pra ky ka qenë qëllimi i këtij propozim vendimi.

z.Qendrim Softolli, theksoi, do të doja të ndërhyjë pak tek kjo pikë sa i përket ndryshimit dhe atë duke u bazuar në përvojat e kaluara sepse ka qenë propozimi që ky objekt të ridestinohet si objekt afarist, hotelier, shëndetësor, dhe tani është propozuar objekt dhe hapësirë që mund të jepet në shfrytëzim për qëllime afariste, hoteliere, shëndetësore, rekreative, sportive apo veprimtari tjera të ngjashme të interesit të përgjithshëm. Ky termi *apo veprimtari tjera të ngjashme* është i gjerë dhe jep hapësirë shumë të madhe për të konkurruar, e që jam kundër kësaj. Ne si LDK-së e kemi pas si propozim por edhe në program që ky objekt të shfrytëzohet për pacient të kujdesit paliativ dhe të destinohet për atë qëllim dhe jo për shfrytëzim sipas pikës së cekur.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim-DSHPMSH, theksoi, termi, *apo veprimtari të ngjashme* nuk e zgjeron shumë fushëveprimin që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm, arsyeje kryesore pse është kërkuar që të bëhet ndërrimi i destinimit të këtij objekti është për shkak se ne të gjithë e dimë se ka vite që është ndërtuar ai objekt dhe asnjëherë askush nuk ka pas ndonjë mundësi që ta merr në shfrytëzim. Interesi i Komunës është që ai objekt të jepet në shfrytëzim dhe të jetë një interes i dy anshëm mes Komunës dhe shfrytëzuesit të atij objekti në mënyrë që ai objekt të mos amortizohet, pastaj për atë objekt janë të angazhuar edhe rojet për çka krijohen edhe shpenzime sepse ai objekt pothuajse është tërësisht i rregulluar dhe nuk bënë të lihet pa roje.

z.Qendrim Softolli, theksoi, pikërisht për atë arsye që është objekt pothuajse tërësisht është i rregulluar dhe me pak investim mund të kompletohet andaj me pak dhe të destinohet qëndrim paliativ të pacientëve.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSSH, theksoi, qëllimi është që të krijohen mundësi që të aplikoj dikush për marrje në shfrytëzim këtë objekt, andaj qëllimi i kësaj është që destinimi i atij objekti të mos të jetë vetëm për një qëllim por të ketë një fushëveprim më të gjerë në mënyrë që t'iu jepet mundësia të gjithëve që kanë interes të aplikojnë për marrjen në shfrytëzim objektin në fjalë, mandej për procedurat tjera vendosin komisionet përkatëse.

znj.Adelina Stublla, theksoi, sa i përket funksionalizimit për qëndrim paliativ që u potencua, duhet të specifikohet se a bëhet fjalë për qëndrim ditor apo qysh sepse është goxha specifika puna e tyre sepse mund të ketë raste kur anëtarët e familjes nuk dëshirojnë t'i dërgojnë të afërmit e tyre ndoshta në atë objekt, andaj lidhur me këtë çështje ne duhet të diskutojmë sepse ai objekt është dashur që në fillim të funksionalizohet për atë qëllim të destinimit që ka qenë, mirëpo tani ka kaluar një kohë e gjatë dhe mendoj se ata fëmijë i takojnë një moshe të rritur dhe kanë më shumë se 20 vjet, kurse tani sipas mendimit tim më e mira do të ishte ai objekt të shndërrohet për qëndrim ditor të pleqve që ne si Komunë nuk e kemi një të tillë, mirëpo pasi që kemi një propozim unë pajtohem që të jetë kështu.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSSH, theksoi, në këtë propozim veçse është cekur se ky objekt parashihet të jepet në shfrytëzim përveç tjerash edhe veprimtari shëndetësore. Pra decidivisht thuhet për veprimtari hoteliere, shëndetësore, rekreative, sportive apo veprimtari tjera të ngjashme të interesit të përgjithshëm

z.Naim Çunaku, theksoi, sa i përket këtij propozimi e dimë se ky vendim është marrë në vitin 2018, e dimë historikun e ndërtimit të asaj qendre dhe nuk po hyjmë në këtë temë ngase jemi dëshmitar të saj se si është ndërtuar dhe si janë ndarë fondet për ndërtimin e atij objekti dhe sigurisht që pa dashur të gjykoj se a ka qenë veprim i duhur ose jo për ndërtimin e atij objekti janë ndarë më shumë se 500,000.00€ nga ana e Komunës dhe çfarë na ka ndodhë e kemi një objekt prej vitit 2004 të ndërtuar në një gjendje përafërsisht të përfunduar, objekt për të cilin Komuna jonë paguan roje dhe mos të them se ndoshta shumë çka brenda këtij objekti është tjetërsuar. Një objekt i tillë destinimin e parë e ka pas për lehtësim dhe nevoja të qytetarëve, ata e shndërrojnë në komercializim me vet faktin se jepet në shfrytëzim.

Në komercializim Komuna e ka fitimin e saj sepse krijon të hyra vetanake dhe jam shumë i vetëdijshëm për këtë, mirëpo ndryshon nga qëllimi primar i tij e që thënë të drejtën që nga propozimet e bëra të z.Qendrim Softollit dhe znj.Adelina Stublla, mendoj se duhet të jetë në pronësi të Komunës mund të shfrytëzohet qoftë për qëndrim ditor të pleqve ose ajo që sakt e propozoi zotëri Softolli sepse mund të kemi secili defekte në shëndetin tonë për faktin se jemi duke e parë gjendjen socio-ekonomike dhe solidaritetin që është duke na ndodhur mes neve pa dashur të hyjë shumë në shëndet kur është zonja Stublla këtu, mirëpo jemi në situatë bukur shumë të paraqitjeve të nevojave edhe të familjeve tona për qëndrim ditor të pleqve apo të sëmurëve, madje sigurisht keni dëgjuar për raste në familjet tona anë e mbanë Kosovës kur në fazën e fundit të jetës familjarët nuk janë në gjendje as që t'i mbajnë as që nuk i mbajnë ndonjërin prej familjarëve të tyre në shtëpi dhe krejt nga qasja e asaj humanitare unë besoj se gjëja më e mirë do të mund ta bënim është të ruajmë destinimin e parë të këtij objekti që ka qenë ndihmë për njerëzit në nevojë, mirë që ata ish fëmijë tashmë janë të rritur dhe janë në moshën madhore mirëpo sigurisht tani gjyshërit e tyre kanë nevojë për një objekt të tillë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me objektin në fjalë unë prej shoqatës së peshkatarëve e kam pas një kërkesë ku ata kanë shprehë dëshirën që objektin në fjalë ta marrin në shfrytëzim, mirëpo ne atij objekti duhet t'ia bëjmë një zgjidhje sepse ka 15 apo 16 vite që nuk është në shfrytëzim, është mirë që tani të krijohet hapësirë më e madhe për të gjithë ata që kanë dëshirë ta shprehin vullnetin e tyre për marrje në shfrytëzim. Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të kaloj në

Kuvend dhe t'i bëhet një zgjidhje sepse ai objekt mund të shkatërrohet pa u përdorur fare e që është një dëm shumë i madh për ne. Këtu është një mos menaxhim i mirë sepse është dashur më herët nga ekzekutivët e kaluara t'i bëhet një zgjidhje këtij objekti, mirëpo gabimet e tyre nuk do të thotë mos t'i përmirësojmë ne. Mendimi im është se kjo pikë e rendit të ditës duhet të kalojë në Kuvend për shqyrtim andaj do e hedhë në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, në këtu patëm dy propozime, ishte propozimi i z.Qendrim Softolli që ky objekt të shndërrohet në një qendër të shërbimit paliativ dhe propozimi i znj.Adelina Stublla që ai objekt të shndërrohet si shtëpi e pleqve.

znj.Adelina Stublla, theksoi, unë atë e thash vetëm si ide.

Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë ne kemi tri propozime por edhe një herë ju sqaroj se qytetarët kanë interesim me marrë këtë objekt në shfrytëzim.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk e di pse i ngatrroni gjërat sepse në këtë propozim është paraparë ri destinimi për veprimtari shëndetësore që e përfshinë edhe shërbimin paliativ dhe atë për qëndrim ditor për pleqtë.

z.Naim Çunaku, theksoi, atëherë ku është qëllimi i ndërrimit të destinimit të këtij objekti.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHMS, theksoi, qëllimi është që t'ju jepet më shumë hapësirë nevojave të qytetarëve në mënyrë që të aplikojnë dhe ta marrin në shfrytëzim këtë objekt sepse deri më tani askush nuk ka shpreh ndonjë interesim konkret dhe deri më tani ky objekt mbetet i pa shfrytëzuar.

Nëse flasim për shërbimin paliativ dhe për qëndrim ditor të pleqve e që e kemi paraparë edhe këtë kategori në këtë propozim vendim.

z.Qendrim Softolli, theksoi, ne e kemi fjalën që ky objekt të mos privatizohet por të mbetet aset i Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, për t'i shtuar asaj që parafolësi e potencoj, ne dëshirojmë ta ruajmë këtë aset të Komunës në atë mënyrë që të menaxhohet nga Komuna.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, pyetja ishte pse është bërë ridestinimi për këtë dhe ne tani jemi në mbledhje të KPF-së dhe si temë e kemi që këtë pikë të rendit të ditës t'ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim sepse në këtu nuk mund të marrim vendim, andaj në këtë pikë vetëm mund t'ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, ky është qëllimi i këtij propozim vendimi sepse në Kuvend në bazë të votave merret vendimi se a mund të destinohet shfrytëzimi i objektit në fjalë apo do të mbetet në pronësi të Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, në rend të parë Komiteti për Politikë dhe Financa është keq që se ka një rregullore të punës ku në mënyrë decidive do të ishin të përcaktuara gjitha procedurat e punës.

Alternativa si propozim për Kuvend mund të jetë si qëndrim nëse kalon ky propozim në KPF që t'i sugjerohet si propozim plotësim Kuvendit, nëse nuk duam refuzohet dhe shkohet kah propozimi juaj.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, theksoi, është mundësia që të procedohet edhe në Kuvend, por sërish ju vendosni.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin e parë sipas rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues, propozimi i parë gjithëherë shkon ai i atij alternativ që ka dhënë propozimin.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, propozimi i parë është ai sipas rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, gabim e kemi gabim i nderuar Kryesues.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dua të ndërlihem me këtë temë sepse ne jemi duke votuar për këto pika të cilat janë të caktuara në bazë të rendit të ditës, dhe pasi që këto pika të kalojnë në Kuvend atëherë mund të ketë propozim që t'i ndërrohet destinacioni objektit në fjalë, unë shumë mirë jam duke e kuptuar këtë

çështje. Në bazë të këtij propozimi jepen hapësirë më e madhe për aplikim për marrje në shfrytëzim atë objekt por duhet të gjendet forma dhe mënyra më e mirë që ky objekt të jepet në shfrytëzim.

z.Qendrim Softolli, theksoi, mënyra e dhënies në shfrytëzim është si një lloj ankandi ai i cili ofron çmim më të lartë e merr në shfrytëzim, mirëpo ne dëshirojmë që ai objekt të mbetet në shfrytëzim nga ana e Komunës për një qëllim të caktuar e jo të hedhet në ankand e ta merr dikush e pastaj të ofrojë atë shërbim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në mbledhjen e radhës në Kuvend mund ta bënë këtë propozimi nderuari z.Qendrim Softolli

z.Naim Çunaku, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk e përkrahim propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018, për dhënien e objektit në shfrytëzim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin e parë sipas rendit të ditës.

Nga 8 anëtarë/e sa ishin prezent për momentin, me 5 vota PËR, 3 vota KUNDËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes .

15. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” Sh.A.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës veç u prezantua në fillim të mbledhjes dhe u sqaruan të gjitha nga drejtori i DBF, andaj edhe këtë pikët të rendit të ditës e hedh në votim nëse veç nuk ka dikush që dëshiron fjalën.

Njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës sipas materialit të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes.

16. Propozim vendim për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020, propozim vendim i njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, rreth kësaj çështje diskutuam në hyrje të kësaj mbledhje, mirëpo nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse atëherë e hedh në votim ashtu siç u propozua.

Me 6 vota PËR, 3 vota KUNDËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozimit për marrjen e një vendimi të ngjashëm me atë të vitit 2021 sipas të cilit pezullohen disa nene të rregullores për orarin e punës së bizneseve dhe atë deri në sjelljen e një draft rregulloreje të re me të cilën do të rirregullohet orari i punës me theks ditëve të diele.

17. Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe për këtë pikë po thuajse u diskutua në fillim të mbledhjes dhe u shpërnda materiali përkatës tek anëtarët e komitetit, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo e hedh në votim sipas materialit përkatës.

Me 6 vota PËR, dhe 3 vota KUNDËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, sipas propozimit të paraqitur në këtë mbledhje.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0014174/22
Podujevë,
25 shkurt 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**